



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-9920/23 datë:19.04.2023



Npi – 01/154 datë: 27.04.2023

Duke u bazuar në nenin 12.2.b. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008); Rregulloren e (MAPL) Nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës; Udhëzimin Administrativ të MAPL-së për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës Nr.02/2015; Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 datë 03.09.2008; Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 27.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES TË PUNËS SË KUVENDIT
DHE KOMITETEVE**

I

Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -IV- të rregullt për vitin 2023, e mbajtur më: 27.04.2023, unanimisht miratoi Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe Komiteteve.

II

A r s y e t i m: Rregullorja e Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe procesin e diskutimit publik me qytetarë. Kuvendi i Komunës, më datën 31.10.2022 ka nxjerrë Vendimin për formimin e komisionit për hartimin e draft-rregullores së re të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve prej 5 anëtarëve. Komisioni ka mbajtur 4 mbledhje dhe ka nxjerrë draftin final, të cilin e ka dërguar në Kuvend për miratim.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi